



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 719 Akti

Nr. 793 Vendimi
Tiranë, më 4.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Mevi Dibra, në datën 2.9.2024, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dashnor Nure**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi në seancën dëgjimore subjektin e rivlerësimit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

i. Z Dashnor Nure është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

ii. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Dashnor Nure i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Xhensila Pine (relatore).

iii. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

iv. Trupi gjykues filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi me mirëkuptim kryesuese znj. Pamela Qirko dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

v. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Dashnor Nure, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji dhe afatin e ushtrimit të tyre.

vi. Subjekti paraqiti provat e shpjegimet brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni. Trupi gjykues, pas marrjes së shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. 3 vendosi ta ftojë subjektin në seancën dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

I. SEANCA DËGJIMORE

vii. Në datën 2.9.2024 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

Seanca dëgjimore u ndërpre, për të vijuar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 4.9.2024.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV NGA KOMISIONI

viii. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit Dashnor Nure, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. ku në përfundim të veprimeve verifikuese ka vlerësuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni kreu një hetim të pavarur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore, administruar në dosje, nga ku ka rezultuar si vijon:

1. Automjeti tip “**”**

1.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë tip “****”, me targë KO *** B, blerë më 28.11.2004. Kam paguar detyrimet doganore. Burimi i krijimit të kësaj pasurie nga të ardhurat personale nga pagat. Vlera: 404.923 lekë. Pjesa e zotëruar: 100%*”.

1.2 Në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë tip “****”, nr. shasie ***, me vlerë 400.000 lekë (180.000 lekë vlera e blerjes sipas kontratës plus 220.000 lekë vlera e zhdoganimit). Data e krijimit të pasurisë: 23.11.2004, kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., zyra noteriale Korçë*”.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.3 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin, i cili aktualisht figuron në status çregjistrimi të përhershëm.

1.4 Nga aktet e administruara rezulton se kjo pasuri është blerë nga subjekti me kontratën e shitblerjes, me palë shitëse Sh.K, në shumën 180.000 lekë, likuiduar sipas kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale.

1.5 Me dokumentin e datës 14.10.2004, automjeti me targa italiane BP *** CR, në pronësi të shtetasit italian C.N, i është shitur në datën 14.10.2004 shtetasit Sh.K kundrejt çmimit 5.300 euro.

1.6 Nga hetimi administrativ i dokumentacionit në datën 23.11.2004, në të cilën është bërë nënshkrimi i kontratës së shitblerjes me subjektin e rivlerësimit, janë kryer edhe procedurat e zhdoganimit të mjetit në pikën doganore të Kapshticës nga subjekti i rivlerësimit.

1.7 Nisur nga fakti që shpenzimet për blerjen e këtij automjeti nga pala shitëse janë në vlerën 5.300 euro, zhdoganimi i mjetit është bërë në vlerën 224.923 lekë dhe direkt pas zhdoganimit subjekti e ka blerë atë shumën 180.000 lekë, ku në kontratë nuk është specifikuar asnjë pretendim sa i takon gjendjes teknike të tij, Komisioni vlerësoi që të pasqyrojë në analizën financiare shumën 5.300 euro, si shumë e paguar për blerjen e mjetit nga subjekti.

1.8 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kallua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit sa nisur nga paqartësitë në dokumentacion si në blerjen e automjetit, ashtu edhe në transportimin, zhdoganimin dhe pagesën e detyrimeve doganore, si dhe ndryshimin e vlerës për një periudhë njëmuajore, duket se nga subjekti janë ndërmarrë veprime dhe hartuar dokumente për fshehje të çmimit real të blerjes së këtij mjeti.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.9 Subjekti në prapësime ka shpjeguar se ka pasur të ardhura të mjaftueshme deri ditën e blerjes së automjetit për të përballuar blerjen e tij si me çmimin e prezumuar prej 5.300 euro, ashtu edhe vlerën e zhdoganimit dhe shpenzimet e tjera të jetesës, si dhe ka pasur mundësi kursimi në vlerën 147.403 lekë dhe nuk ka pasur arsye për të fshehur apo të bëjë përpjekje për të fshehur çmimin e automjetit.

Analiza e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare

1.10 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar “të ardhura personale nga paga” për blerjen e këtij automjeti. Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2004, subjekti në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme ka deklaruar: “*Autoveturë tip “****”*”. Në këtë vit, subjekti gjithashtu ka deklaruar edhe gjendje *cash* në vlerën 900.000 lekë, me përshkrimin “Të akumuluar gjatë vitit 2004 nga pagat dhe kredia e marrë”.

1.11 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, kreu analizën financiare për vitin 2004, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e automjetit, krijim të kursimeve *cash* 900.000 lekë, dhe kryerjen e shpenzimeve deri në datën 31.12.2004, konkretisht:

- Lidhur me të ardhura nga shitja e mjetit të mëparshëm, në përgjigje të pyetësorit shtesë nr. 2, subjekti deklaroi se: “*Autoveturën e regjistruar në datën 12.2.2003 e kam shitur rreth 200.000 lekë dhe nuk kam ruajtur ndonjë dokument që vërteton blerjen apo shitjen e tij*”.
- Të ardhurat e deklaruara nga shitja e automjetit tip “****” nuk janë të përfshira në analizën financiare, pasi burimi i deklaruar nga shitja e automjetit të mëparshëm, ashtu edhe blerja e tij, mbeti deklarativ, pa u provuar nga ana e subjektit me dokumentacion ligjor.
- Me dokumentin e datës 22.12.2004, në dosjen e kredisë specifikohet se kredia është për pagesën e huas që subjekti ka ndaj një mikut të tij, marrë për blerjen e automjetit.
- Në formularin e aplikimit për kredi, marrja e kësaj kredie u pasqyrua për qëllimin e shlyerjes së huas, fakt i cili nuk është deklaruar nga subjekti as deklaratën *Vetting*, as në deklarin vjetor dhe as në shpjegimet e dhëna në pyetësorë.

1.12 Nisur nga sa më sipër, si dhe fakti që kredia është marrë më vonë në kohë, rreth dy muaj nga blerja e automjetit, dhe ka mbetur gjendje në llogarinë bankare pa u tërhequr nga subjekti deri në vitin 2005, Komisioni vlerësoi se kjo kredi nuk mund të përfshihet në analizën financiare për blerjen e automjetit.

Tabela nr. 1

Analiza e treguesve financiarë për periudhën	1.1.2004 – 31.12.2004
Përshkrimi	Vlera në lek
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit, dokumentuar për periudhën	1.030.110
Të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm tip “****”	0
Kredi e marrë në ProCredit Bank	600.000
Total të ardhura/të hyra financiare	1.630.110
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT - ILDKPKI për periudhën	93.964
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	48.266
Shpenzime të shumës 100.000 lekë nga kredi në ProCredit Bank	100.000
Pagesë për blerje automjeti tip “****”, shuma 5.300 euro	669.655
Shpenzime zhdoganimit në datën 23.11.2004	224.923
Total shpenzime/të dala financiare	1.136.808
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	-900.000
Ndryshim mj. monetare në bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-500.000
Mjete monetare të disponueshme	-906.698

1.13 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në shumën -906.698 lekë për blerjen e automjetit tip “****” në shumën 5.300 euro dhe pagimin e shpenzimeve të zhdoganimit, krijim të likuiditeteve *cash* në shumën 900.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2004.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.14 Subjekti në prapësime ka shpjeguar se automjeti është blerë në datën 23.11.2004. Të ardhurat neto nga pagat deri më 23.11.2004, datë në të cilën është blerë automjeti, janë në vlerën 926.380 lekë. Subjekti ka përfshirë deri në këtë periudhë edhe të ardhurat nga shitja e automjetit të blerë në datën 12.2.2003, deklaruar në DPV-në e vitit 2003, të cilën e ka shitur në datën 21.10.2004, deklaruar në DPV-në e vitit 2004.

1.15 Për të vërtetuar të ardhurat nga shitja e këtij automjeti, subjekti ka paraqitur si dokumentacionin provues:

- Vërtetimin e noterës F.B.L, të datës 12.8.2024, ku në regjistrin e akteve dhe veprimeve noteriale të vitit 2003 rezulton i regjistruar akti kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2003, me palë shitëse F.F dhe blerës Dashnor Nure, në vlerën 250.000 lekë. Bashkëlidhur është paraqitur procesverbali i asgjësimit i akteve noteriale të datës 30.6.2016, si dhe faqet *** e *** të indeksit të viteve 2003 – 2004. Subjekti ka paraqitur kontratën e

shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2003, me palët e mësipërme, në vlerën 250.000 lekë.

- b. Vërtetimin e noteres F.B.L, të datës 12.8.2024, ku në regjistrin e akteve dhe veprimeve noteriale të vitit 2004 rezulton i regjistruar akti kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2004, me palë shitëse Dashnor Nure dhe blerës I.S.R, në vlerën 250.000 lekë. Bashkëlidhur është paraqitur procesverbali i asgjësimit i akteve noteriale të datës 30.6.2016, si dhe faqet *** dhe *** të indeksit të viteve 2004 – 2005. Subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2004, me palët e mësipërme, në vlerën 250.000 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.16 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet në seancën dëgjimore – arsyeton se:

1.17 Pikat 1, 2 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaratimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklaratimin saktësisht dhe mjaftueshëm të pasurisë dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast është origjina, veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, si dhe mjetet financiare për krijimin e saj.

Lidhur me deklaratimin e kësaj pasurie

1.18 Siç është provuar nga hetimi administrativ në kohën e hartimit të dokumentacionit ligjor për përfitimin e pasurisë automjet, veprimet ligjore të hartimit të kontratës së shitblerjes u kryen nga subjekti i rivlerësimit, duke u deklaruar se ai ka paguar shumën prej 180.000 lekësh për blerjen e këtij automjeti, i cili vetëm 40 ditë më parë ishte blerë në vlerën 5.000 euro.

1.19 Komisioni, pasi administroi dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe e dëgjoi në seancën dëgjimore, çmon se subjekti nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me çmimin e blerjes së automjetit. Nga analiza e fakteve duket se palët kanë pasur si qëllim shmangien e deklaratimit të vlerës reale të përfitimit të kësaj pasurie të luajtshme, e cila referuar gjithë dokumentacionit të administruar, rezultoi të ishte e ndryshme nga ajo e deklaruar nga palët. Shitja e automjetit në të njëjtën ditë me futjen e automjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pagimit e taksës doganore me një vlerë 33% të çmimit të blerjes nga blerësi i mëparshëm, rezulton se është gjithashtu një veprim financiar i pajustificuar dhe i pabesueshëm.

1.20 Gjithashtu, pretendimi i subjektit se edhe po të merret vlera 5.300 euro si çmim blerjeje për automjetin subjekti i rivlerësimit rezulton me mundësi financiare për blerjen e tij, nuk rezulton e mbështetur nga faktet e hetimit administrativ, pasi rezultoi se subjekti ka deklaruar në të njëjtin vit

në DIPP/2004 edhe gjendje *cash* në vlerën 900.000 lekë, me përshkrimin “Të akumuluar gjatë vitit 2004 nga pagat dhe kredia e marrë.

1.21 Neni 681 i Kodit Civil, i cili parashikon se kur interpretohet një kontratë duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës, vlera provuese e kontratës së shitblerjes duhet të vlerësohet dhe çmohet duke e interpretuar atë sipas qëllimit të palëve.

1.22 Organet e rivlerësimit kanë pranuar në jurisprudencën e tyre të konsiderojnë të pavërteta elementet e deklaruara në kontrata të ndryshme në të cilat kanë marrë pjesë subjektet e rivlerësimit, pavarësisht faktit se ato kanë qenë deklarime të bëra para një noteri publik dhe nuk kanë qenë kontestuar prej palëve, pikërisht se për shkak të veçorisë së këtij procesi, jo me natyrë civile të pastër, vlerësimi dhe gjykimi i çështjeve mund të bëhet në zbatim të normave procedurale të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të zbatueshme në përputhje me parashikimin referues që bën pika 6 e nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

1.22.1 Në këtë kontekst duhen konsideruar edhe dispozitat e Kodit Civil për interpretimin e kontratave, për sa kohë palët deklarojnë një qëllim të caktuar në përpilimin e tyre në formën dhe përmbajtjen që rezulton se kanë, edhe për shkak se ky qëllim i deklaruar i palëve nuk mbështetet nga të dhënat e përfuara nëpërmjet burimeve të tjera të provës.

1.22.2 Çmimi i deklaruar në hartimin e kontratës së shitblerjes së automjetit, sa më sipër arsyetuar, u konsiderua nga trupi gjykues si përpjekje të subjektit për të deformuar apo manipuluar të vërtetën në funksion të paraqitjes së rreme të të dhënave lidhur me pasurinë objekt hetimi, me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme.

1.22.3 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me ligjshmërinë e veprimit të kryer për përfitimin e kësaj pasurie sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të analizuara edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

Lidhur me mundësinë financiare

1.23 Pasi vlerësoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmon se mbeti e paprovuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për ta përfituar këtë automjet.

1.24 Subjekti në prapësime ka pretenduar se lidhur me gjendjen *cash* në shumën 900.000 lekë, të deklaruar në DPV-në e vitit 2004, deklarimi është bërë në muajin mars dhe shuma e kredisë është tërhequr në janar të vitit 2005, prandaj gjendja *cash* duhet të jetë pasqyruar si gjendje në kohën e deklarimit.

1.25 Sipas shpjegimeve të subjektit, shuma 500.000 lekë e tërhequr nga banka në janar të vitit 2005 duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm i krijimit të shumës *cash* për vitin 2004.

1.26 Trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit lidhur me mungesën e deklarimit të gjendjeve *cash* në deklaratat periodike, sipas të cilave saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota.

1.27 Gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara për vitin 2004 nuk mund të provohen ndryshe, përveçse me deklaratën periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie, që mund ta provojë atë.

1.28 Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt, që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, trupi gjykues vlerësoi se edhe nëse do të konsideronte në analizën përfundimtare financiare të kryer skenarin më favorizues e garantues për subjektin e rivlerësimit, edhe duke marrë në konsideratë vlerën e shitjes së automjetit të mëparshëm prej 250.000 lekësh, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit në vitin 2004 do të rezultonte me pamundësi financiare në vlerën -656.698 lekë për krijimin e pasurisë së luajtshme, krijimin e likuiditeteve të deklaruara dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2004.

1.29 Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie të luajtshme në vitin 2004, duke mos provuar mundësinë financiare që me të ardhura të ligjshme të mundësonte pagimin e çmimit të kësaj pasurie të luajtshme.

1.30 Në konkluzion lidhur me këtë pasuri të luajtshme, trupi gjykues vlerëson se veprimet e subjektit për të deformuar të vërtetën lidhur me këtë pasuri përfaqësojnë përpjekjet e tij për të justifikuar mungesë burimesh të ligjshme dhe se këto veprime rezultojnë të shoqëruara me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagimin e pasurisë, duke e vendosur subjektin në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të analizuara edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

2. Gjendja *cash* e deklaruar

2.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash në shumën 650.000 lekë. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e mia personale nga pagat. Pjesa e zotëruar: 100%*”.

2.1.1 Në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash në shumën 900.000 lekë. Burimi i krijimit: Të akumuluarat gjatë vitit 2004 nga pagat dhe kredia e marrë. Pjesa e zotëruar: 100%*”. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike vjetore të viteve 2005 – 2017, pra deri në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar kursime, shtesa/pakësime në *cash*.

2.1.2 Referuar deklarimeve të gjendjeve *cash* sipas DIPPV-ve, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* vetëm në DPV-në e vitit 2004, ndërsa për të gjithë periudhën deri në deklaratën *Vetting* nuk janë deklaruar kursime, shtesa/pakësime në gjendjen *cash*.

2.1.3 Në përgjigje të ILDKPKI-së, në shkurt të vitit 2016, në lidhje me gjendjet *cash* të deklaruara, ka shpjeguar se: “*Vijoj t’i zotëroj. Është e njëjta shumë*”.

2.2 Referuar ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenin 4 përcaktohet se: “...Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: ...d) vlerën e likuiditeteve”.

2.3 Komisioni kreu një analizë financiare për periudhën 1.1.2017 – 30.1.2017, mbështetur në dokumentacionin e administruar, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për krijimin e kursimeve *cash* në vlerën 650.000 lekë, në datën 30.1.2017, paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 2

Analiza e treguesve financiarë për periudhën	1.1.2017 – 30.1.2017
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat nga punësimi i subjektit, dokumentuar për periudhën	125.006
Total të ardhura/të hyra financiare	125.006
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT - ILDKPKI për periudhën	18.744
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	0
Shpenzime për telefoni në Credins Bank për periudhën	720
Total shpenzime/të dala financiare	19.464
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim – gj. fund periudhe	-644.177
Ndryshim mj. monetare në bankë, dokumentuar gj. fillim – gj. fund periudhe	-7286
Mjete monetare të disponueshme	-545.921

2.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ka kaluar barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit lidhur me sa subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare, duke rezultuar me balancë negative në shumën -545.921 lekë, për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 650.000 lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.5 Subjekti në prapësime ka dhënë shpjegimet si vijon: “Në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*, në shumën 650.000 lekë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, përfaqëson gjendjen *cash* për të gjithë periudhën e rivlerësimit, 1.6.1995 – 30.1.2017.

*Nga analiza financiare e kryer, rezulton se për vitet 2014, 2015 dhe 2016 kam pasur mundësi të kursimit në vlerat respektive: 693.844, 696.920 dhe 689.190 lekë, por vetëm në 2016-ën mundësia për të kursyer ka qenë 689.190 lekë, pra më e madhe se gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting*.*

*Pra, në këtë kuptim, i kam pasur të gjitha mundësitë të disponoja shumën 650.000 lekë. Në këtë kuptim, edhe sikur të prezumohet se kjo shumë është krijuar vetëm nga të ardhurat e vitit 2016, për këtë vit rezulton një balancë pozitive prej 49.100 lekësh, kjo balancë duhet të vlerësohet në funksion edhe të deklaratës *Vetting*, si gjendje *cash* për të gjithë periudhën e rivlerësimit, që pasqyrohet në deklaratën *Vetting*.*

Faktin se kjo shumë nuk është pasqyruar, për shkak pakujdesie në deklaratën vjetore të vitit 2017, mendoj se kjo duhet të vlerësohet si pasaktësi e deklaramit vjetor 2017, por jo si mungesë e burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes cash. Konkluzioni se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për të krijuar këtë shumë, nuk është i bazuar”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.6 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramit e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaramit periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaramit në seancën dëgjimore – arsyeton se:

2.7 Në lidhje me gjendjen *cash*, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin në bazë të ligjit nr. 9049/2003 për të pasqyruar çdo ndryshim të gjendjes *cash* në çdo deklaramit periodik në gjendjen që ishte më 31 dhjetor të vitit të mëparshëm.

2.8 Neni 4 parashikon: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”.*

2.8.1 Pretendimi i subjektit se nga analiza financiare e kryer rezulton se për vitet 2014, 2015 dhe 2016 kam pasur mundësi të kursimit në vlerat respektive 693.844 lekë, 696.920 lekë dhe 689.190 lekë, por vetëm në 2016-ën mundësia për të kursyer ka qenë 689.190 lekë, pra më e madhe se gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting*, nuk mbështetet nga deklaramit periodike të tij, në të cilat ai nuk ka deklaruar gjendje *cash* gjatë viteve përkatëse.

2.8.2 Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk mund të merren në konsideratë, për sa kohë detyrimi i tij ligjor për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklaramin e çdo pasurie të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet në formën *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

2.8.3 Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se marrja në konsideratë e këtij likuiditeti është një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, i ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë dhe pakësim të pasurisë në çdo formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik.

2.9 Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave, lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*, sipas kërkesave të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi nuk arriti të provojë se ato ishin pikërisht të ardhurat e ndodhura në formë likuiditetesh *cash* ndër vite nga ana e subjektit.

2.10 Trupi gjykues arriti në konkluzionin e mësipërm, pasi vlerësoi se nuk ka një logjikë të besueshme në deklaramit e subjektit mbi mbajtjen në banesë të shumës së kursimeve *cash* për vitet 2003 – 2016, i cili, jo vetëm mbetet deklarativ dhe i paprovuar, por edhe i pabesueshëm dhe

jobindës, si dhe nuk përkon me sjelljen e subjektit në vijimësi, kur nga viti 2006 ai është investuar në marrëdhënie kreditimi, për të cilat ka pasur pamundësi shlyerjeje si më poshtë analizuar.

3. Historiku i kredive të marra ndër vite nga subjekti i rivlerësimit

a) Kredia konsumatore datë 6.6.2006, me Raiffeisen Bank, në shumën 700.000 lekë

3.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Deri në datën 27.6.2013 nuk kanë qenë shlyer ndaj Raiffeisen Bank shumat 194.276,63 lekë nga kredia dhe 151.615,28 lekë nga *overdraft*-i. Këto shuma të kredisë te Raiffeisen Bank kanë kaluar tek “***” sh.p.k. në datën 5.7.2013. Me marrëveshjen datë 27.1.2017 me “***” sh.p.k., detyrimi ndaj “***” sh.p.k. është 380.000 lekë, që do të shlyhet për 19 muaj, me këst 20.000 lekë në muaj”.

3.2 Në deklaratën *Vetting*, subjekti gjithashtu ka deklaruar: (i) kredi konsumatore datë 6.6.2006, me Raiffeisen Bank, në shumën 700.000 lekë, pa kolateral, me afat 120 muaj, me këst mujor 17.775 lekë, shuma e pashlyer 0 (zero) lekë; (ii) *overdraft* në shumën 156.000 lekë, shuma e pashlyer 0 (zero) lekë.

3.3 Nga verifikimi i deklaratave vjetore të pasurisë rezulton se subjekti ndër vite ka deklaruar shlyerjen e kësaj kredie, si më poshtë vijon:

- Në DPV-në e viteve 2006 – 2010 ka deklaruar shumën e shlyer, si dhe detyrimin e pashlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit për kredinë e marrë në Raiffeisen Bank.

- Në DPV-në e viteve 2011 – 2012 deklararon vetëm detyrimin e pashlyer ndaj kredisë marrë në Raiffeisen Bank, i cili është në vlerë të njëjtë për të dyja vitet.

3.4 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se:

i) Kredia në Raiffeisen Bank në shumën 700.000 lekë është disbursuar në datën 7.4.2006 (nga *statement*-i i bankës rezulton se kredia është disbursuar në datën 7.6.2006, me afat 120 muaj) dhe mbyllur në datën 20.8.2013.

ii) *Overdraft*-i në Raiffeisen Bank në shumën 156.000 lekë është disbursuar në datën 12.8.2005 dhe mbyllur më 12.8.2013. Me dokumentin e Raiffeisen Bank konfirmohet se subjekti ka përfituar një *overdraft* në shumën 75.000 lekë dhe detyrimi i mbetur deri në datën 27.6.2013 është 151.615,28 lekë.

3.5 Në dokumentacionin e administruar në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka qenë në pamundësi likuidimi detyrimi ndaj Raiffeisen Bank për kredinë dhe *overdraft*-in.

3.6 Me marrëveshjen lidhur ndërmjet shoqërisë huadhënëse “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huamarrësit, detyrimet për kredinë në vlerën 485.854,16 lekë ndaj Raiffeisen Bank dhe *overdraft*-i në vlerën 151.615,28 lekë i kanë kaluar shoqërisë huadhënëse.

3.7 Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje, duke nisur nga data 27.6.2013, huamarrësi është debitor ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. për detyrimin e shumës 380.000 lekë, e cila do të paguhet prej tij me këste mujore me vlerë 20.000 lekë, për periudhën janar 2017 – korrik 2018.

3.8 Komisioni gjatë hetimit i kërkoi Raiffeisen Bank informacion mbi kreditë dhe transaksionet në këtë bankë, e cila konfirmon kredinë e marrë nga subjekti, por nuk disponon dokumentacion, pasi pas plotësimit të afatit rezulton të jenë asgjësuar.

3.9 Banka Kombëtare Tregtare konfirmon se janë regjistruar transaksione të kryera në arkë për periudhën 1.3.2017 – 7.2.2019 në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., gjë e cila konfirmohet edhe nga raporti i kredimarrësit.

3.10 Me pyetësorin shtesë nr. 2 i është kërkuar subjektit të japë shpjegime mbi qëllimin/objektin e marrjes së kredisë në shumën 700.000 lekë, në Raiffeisen Bank, si dhe destinacionin e shumave të tërhequra pas disbursimit.

3.11 Në përgjigje të tij, subjekti sqaron se kredia ka qenë konsumatore dhe është marrë me qëllim blerjeje pajisjesh dhe orendish, por në fakt nuk ka mundur ta realizojë për këtë qëllim dhe është përdorur për shpenzime të përditshmërisë dhe për shlyerjen e kësteve të kësaj kredie dhe të kredisë së mëparshme.

b) Kredia konsumatore, datë 6.9.2007, me National Bank of Greece, në shumën 500.000 lekë

3.12 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Kredi konsumatore, datë 6.9.2007, me National Bank of Greece (NBG Bank) (sot ABI Bank), në shumën 500.000 lekë, pa kolateral, me afat 60 muaj, me kësht mujor 12.424 lekë. Deri në datën 20.6.2012, me kamatëvonesat kishte mbetur pa shlyer nga kredia në NBG Bank shuma prej 365.673,30 lekësh. Kjo shumë është ekzekutuar nga zyra përmbartimore A.L, duke paguar nga paga 30.000 lekë në muaj gjatë vitit 2013, pjesa tjetër në janar 2014. Në datën 10.3.2014 vërtetohet shlyerja totalisht e detyrimit”*.

3.13 Nga verifikimi i deklaratave vjetore të pasurisë rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër vite shlyerjen e kësaj kredie, si vijon:

- a) Në DPV-në e viteve 2007 – 2010 ka deklaruar shumën e shlyer, si dhe detyrimin e pashlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit për kredinë e marrë.
- b) Në DPV-në e viteve 2011 – 2012 ka deklaruar vetëm detyrimin e pashlyer ndaj kredisë së marrë në vlerën 325.000 lekë, gjë e cila tregon se ai ka qenë në pamundësi për ta shlyer këtë detyrim ndaj NBG Bank.
- c) Në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar shumën e shlyer prej 360.000 lekësh, si dhe detyrimin e pashlyer në vlerën 16.000 lekë deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.
- d) Në DPV-në e vitit 2014 nuk ka deklaruar shumën prej 16.000 lekësh të likuiduar për këtë kredi, mbetur nga viti 2013.

3.14 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se me formularin e kredisë me klient nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi konsumatore në datën 6.9.2007 tek National Bank of Greece (NBG Bank), në shumën 500.000 lekë (për qëllim mobilie, pajisje). Kredia është mbyllur në datën 5.4.2019.

3.15 Po në këtë dosje, subjekti i rivlerësimit rezulton klient me vonesë ndaj bankës që prej datës 6.9.2010, me vlerën e detyrimit 365.673,30 lekë. Me kontratën e shërbimit, NBG Bank ka kërkuar

nga zyra përbarimore vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv kontratë kredie bankare, datë 21.8.2007.

3.16 Nga aktet e administruara në dosjen e DPSHTRR-së, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2021, zyra përbarimore “***”, me shkresë i paraqiti kërkesë DPSHTRR-së për moskryerjen e asnjë veprimi për ndryshim pronësie, nëse ekziston automjet në emër të subjektit, duke marrë masën e bllokimit të veprimeve deri në një urdhër të dytë.

3.17 Me urdhër zyra e përbarimit vendosi heqjen e sekuestros konservative mbi automjetin e subjektit, pasi në datën 10.3.2014 pala debitore shleu tërësisht detyrimin ndaj NBG Bank.

3.18 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së, me vendim është vendosur pushimi i ekzekutimit si rezultat i shlyerjes së detyrimit nga subjekti. ABI Bank konfirmon se subjekti i rivlerësimit në datën 10.3.2014 ka shlyer totalisht detyrimin.

3.19 Me pyetësorin shtesë nr. 2, subjekti i është kërkuar të japë shpjegime mbi qëllimin e marrjes së kësaj kredie, si dhe destinacionin e shumës së tërhequr *cash* në datën 11.9.2007. Në përgjigje të tij, subjekti ka sqaruar se: “*Kredia ka qenë konsumatore, kam dashur të blej pajisje edhe për të afërmit e mi. Është përdorur edhe për shlyerjen e kësteve të kësaj kredie si kredive të mëparshme*”.

3.20 Trupi gjykues, në analizë të historikut të kredive të mësipërme, vlerëson se nuk ka një logjikë të besueshme në deklaratimet e subjektit lidhur me gjendjen *cash* të pretenduar ndër vite, e cila sipas deklaratimit të subjektit mbeti e papërdorur deri në deklaratën *Vetting*, dhe sjelljes së tij në këto marrëdhënie kreditimi.

3.21 Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka dështuar të provojë ekzistencën e një lidhjeje të arsyeshme dhe të logjikshme mes ekzistencës së shumës së pretenduar si gjendje *cash* ndër vite dhe përdorimit të saj si burim të shumës së deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën *Vetting*.

3.22 Në konkluzion të sa më sipër, lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*, trupi gjykues vlerëson se veprimet e subjektit për të deformuar të vërtetën lidhur me deklaratimin e gjendjes *cash*, të shoqëruara me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar gjendjen *cash* të deklaruar, e vendosin subjektin në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të analizuara edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

4. Adresat e banimit deklaruar nga subjekti

4.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar adresën e regjistruar në gjendjen civile: *Lagjja Nr. ****, rruga “***”, p. ***, h. ***, ap. ***, ***, Korçë.

4.2 Në DPV-në e viteve vitet 2003 – 2006 ka deklaruar adresën *E*.

4.3 Në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar adresën e regjistruar gjendjen civile: *Lagjja Nr. ****, rruga “***”, Korçë.

4.4 Në DPV-në e vitit 2011 ka deklaruar adresën e banimit: *Lagjja Nr. ****, rruga “***”, Pallati i ***, ***, Korçë.

4.5 Në DPV-në e vitit 2017 ka deklaruar adresën e regjistruar në gjendjen civile: *Lagjja Nr. ***, rruga “***”, p. ***, h. ***, ap. ***, ***, Korçë.*

4.6 Sa më sipër, nga subjekti ka mosdeklarim të adresave të banimit në DPV për periudhën 2008 – 2010, si dhe periudhën 2012 – 2016, në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” (*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to*).

4.7 Në pyetësoin e depozituar në ILDKPKI, datë 29.2.2016, subjekti ka deklaruar: “*Nga viti 2003 – 2007 kam banuar në E. Nga viti 2007 e në vijim jetoj në Korçë. Në Korçë kam banuar rreth 2 vjet në banesën e vëllezërve të mi. Ata kanë një banesë private të tyre, të ndërtuar pas vitit 2000, të cilën e kanë në proces legalizimi. Ata jetojnë me nënën time. Prej vitit 2009 e në vijim kam banuar në banesa të marra me qira. Janë disa të tilla. Nuk kam pasur në asnjë rast kontrata të lidhura para noterit”.*

4.8 Në përgjigje të pyetësoin shtesë drejtuar nga Komisioni në datën 22.1.2021, subjekti i rivlerësimit, lidhur me adresat e banimit të tij ndër vite, ka deklaruar se *për periudhën 2000 – 2007 ka banuar në E në shtëpinë e së motrës, e cila paguante qiranë (në shumën 5.000 lekë) dhe ndonjëherë e paguante vetë subjekti.*

4.9 Në periudhën 2005 – 2007 banonte përsëri tek familja e së motrës, e cila ka marrë një tjetër banesë me qira në qytetin e E, me vlerë 6.000 lekë.

4.10 Në vitet 2007 – 2010, pas transferimit në qytetin e Korçës, subjekti ka deklaruar se ka jetuar tek banesa e së motrës, e marrë me qira në Lagjen Nr. ***. Vlera e qerasë ka qenë 5.000 lekë.

4.11 Për periudhën 2010 – prill 2012 ka jetuar tek familja e motrës, e cila ka blerë një apartament në qytetin e Korçës.

4.12 Në periudhën 2007 – 2012, subjekti deklaroi se ka qëndruar në periudha të ndryshme edhe në banesën e vëllezërve të tij, A.N dhe F.N.

4.13 Në vitet 2012 – nëntor 2019 ka qëndruar me qira në Lagjen Nr. ***, Korçë, rruga “***”, h. ***, ap. ***, kati ***, për të cilën ka paguar qira në shumën 7.000 lekë, e cila është rritur në 8.000 lekë dhe për të cilën nuk ka pasur të nënshkruar kontratë qiraje.

4.14 Në nëntor të vitit 2019 ka qëndruar me qira në Lagjen Nr. ***, rruga “***”, objekti ***, hyrja ***, Korçë.

4.15 Komisioni, me pyetësoin shtesë nr. 2, datë 27.2.2024, i kërkoi subjektit shpjegime dhe dokumentacion mbi adresat e banimit në gjendjen civile gjatë viteve 2008 – 2010 dhe 2012 – 2016.

4.16 Subjekti i rivlerësimit deklaroi se pas transferimit të tij në Korçë në vitin 2007, familja e motrës ka marrë me qira një banesë në këtë qytet, në Lagjen Nr. ***. Një periudhë kohe ka banuar në shtëpinë e së motrës dhe pjesën tjetër në banesën e vëllezërve të tij, A.N dhe F.N. Në vitin 2010, familja e së motrës ka blerë një apartament në qytetin e Korçës, në të cilin subjekti deklaroi se ka jetuar deri në prill të vitit 2012.

4.17 Sa i takon mosdeklarimit të adresave të banimit, subjekti sqaron: *“Kam vënë re mungesën e adresës dhe në deklarime të tjera vjetore. Ky mund të jetë një lapsus, me mendimin se shërben vetëm si adresë ku mund të marr njoftime në lidhje me deklarimin dhe kam konsideruar si adresë edhe adresën e vendit të punës”*.

4.18 Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Korçë, me shkresë informon se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës 1.1.2003 – 31.3.2005 ka qenë me vendbanim në fshatin ***, njësia administrative ***, ***, Bashkia Kolonjë.

4.19 Në datën 31.3.2005 është shpërngulur me vendbanim në Zyrën e Gjendjes Civile E. Në periudhën 31.3.2005 – 23.11.2007 ka qenë me vendbanim në qytetin e E.

4.20 Në datën 23.11.2007 është shpërngulur me vendbanim në Zyrën e Gjendjes Civile, njësia administrative Korçë. Referuar të dhënave nga Zyra e Gjendjes Civile, njësia administrative Korçë, gjatë periudhës 15.11.2007 – 31.12.2017 ka qenë me vendbanim në qytetin e Korçës, në adresën: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, pallati ***.

Sa më sipër, duket se subjekti ka qenë kontradiktor në deklaram adresash banimi, pasi:

- Ka mospërputhje të deklarimit të subjektit në deklaratën e dhënë prej tij në ILDKPKI në shkurt të vitit 2016, sipas së cilës për periudhën 2000 – 2007 ka jetuar në shtëpi të marrë me qira, për të cilën deklaroi se nuk e njihte qiradhënësin, ndërsa gjatë procesit administrativ në pyetësin shtesë deklaroi se për të njëjtën periudhë ka jetuar në shtëpinë e motrës.

- Ka mosdeklarim të adresave të banimit në DPV për periudhën 2008 – 2010, në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” (Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to).*

- Ka mospërputhje të adresës së deklaruar prej subjektit në pyetësin shtesë për vitet 2012 – 2017, në të cilin deklaroi se adresa e tij e banimit për këtë kohë ka qenë: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, h. ***, ap. ***, kati ***, Korçë, me adresën e vendbanimit të pasqyruar nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, për periudhën 15.11.2007 – 31.12.2016, sipas të dhënave të së cilës adresa e banimit të subjektit është: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, pallati ***.

4.21 Në analizë të sa më sipër arsyetuar lidhur me mospërputhjet e adresave të vendbanimit të deklaruara nga subjekti për të gjithë periudhën e rivlerësimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, sa duket se:

- Subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime e shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, nga të cilat referuar edhe vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duket se bëhet e pamundur të dallohet se cili deklaram është i vërtetë dhe cili ka qenë shkaku i vërtetë që e ka detyruar subjektin për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht adresat e banimit ndër vite.

- Përveç mungesës së koherencës në deklarime, duket se konstatohen përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave lidhur me vendbanimet e tij, të cilat nuk provohen nga hetimi administrativ, që duket se e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.22 Subjekti në prapësime ka dhënë shpjegimet si vijon: *“Lidhur me mungesën e adresës, mund të jetë një lapsus, me mendimin se shërben vetëm si adresë ku mund të marr njoftime në lidhje me deklarin dhe kam konsideruar si adresë edhe adresën e vendit të punës.*

Në deklaratat vjetore deri nga viti 2011 nuk kanë ekzistuar shënimet dhe shpjegimet se çfarë duhet të plotësohej në çdo rubrikë”.

4.23 Banesat në të cilat ai ka qëndruar nuk kanë qenë të formalizuara dhe të regjistruara në ZRPP dhe sipas tij vendosja e adresës ka qenë vetëm për marrjen e njoftimit e si rezultat ka vendosur adresën e punës. Sipas shpjegimeve të subjektit, ai asnjëherë nuk ka pasur banesë dhe mospërputhjet në deklarime kanë ardhur si rezultat i deklarinimit të adresës së qëndrimit dhe jo asaj të regjistrimit të gjendjes civile.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.24 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklarinimet në seancën dëgjimore – arsyeton se:

4.25 *Mosdeklarinimi i adresave të banimit në DPV është në kundërshtim me detyrimin ligjor, pasi referuar nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për kontrollin dhe deklarinimin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI: (a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to.*

4.26 Deklarinimet e subjektit të rivlerësimit dhe shpjegimet e dhëna e bëjnë deklarinimin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4.27 Sa i takon konstatimit të Komisionit për përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave lidhur me vendbanimet e tij, të cilat duket se e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e barrës së provës të ngarkuar nga Komisioni.

4.28 Subjekti ka dhënë shpjegime vetëm pas rezultateve të hetimit mbi mosdeklarimin e shumave të qirasë, për shkak të vlerës së ulët të shpenzimit, nën pragun ligjor të deklarimit (300.000 lekë). Trupi gjykues i gjen të pabazura dhe jobindëse shpjegimet e subjektit, për sa kohë nga vetë historiku i marrëdhënieve të kreditimit të analizuar nga dokumentacioni ligjor i administruar dhe nga deklaratimet e subjektit lidhur me këto kredi, ka rezultuar se ai i kishte marrë ato për blerje mobiliesh, duke e bërë të paplotë shpjegimin e tij lidhur me situatën faktike të përdorimit të banesave dhe të pasqaruar lidhur me argumentet e tij lidhur me to.

4.29 Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime e shpjegime të pasakta dhe kontradiktore lidhur me vendbanimet e tij dhe të paprovuar për sa i përket mungesës së koherencës në deklarime, përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave lidhur me vendbanimet e tij, e vendosin atë në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e të ligjit nr. 84/2016.

Banesa e deklaruar në përdorim nga subjekti, godina e banimit 2 kate në qytetin e Korçës

4.30 Në përgjigje të pyetësorit shtesë drejtuar nga Komisioni në datën 22.1.2021, subjekti deklaroi se në periudhën 2007 – 2012 ka qëndruar në periudha të ndryshme edhe në banesën e vëllezërve të tij, A.N dhe F.N, apo në banesën e së motrës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe pyetësorit vijnë në kundërshtim me deklaratimet periodike ndër vite, në të cilat ai nuk ka deklaruar përdorim të banesave të familjareve të tij.

4.31 Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2024, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion nga ASHK, Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë, e cila me shkresë konfirmon shtetasin A.E.N, vetëdeklarues në datën 14.11.2006, i pajisur me vendim legalizimi nr. *** , datë 27.2.2017, për objektin godinë banimi 2 kate, Korçë.

4.32 Nga dokumentacioni i administruar për legalizim, rezultoi se me dokumentin vetëdeklarim për legalizim, datë 14.11.2006, shtetasi A.E.N ka nënshkruar formularin e vetëdeklarimit për objektin shtëpi, viti i ndërtimit 2000, me sipërfaqe ndërtimi 145 m², sipërfaqe e zënë 209 m², me adresë Rruga ***.

4.33 Në vijim të hetimit administrativ, Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2024, i kërkoi Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kopje të printuar apo fizike të lejes së legalizimit nr. *** , datë 27.2.2017. Nga procesverbali i marrjes në dorëzim të dosjes, rezultoi se ende nuk ka përfunduar procesi i emetimit të vendimit përfundimtar për pajisjen me leje legalizimi, pasi praktika vazhdon të jetë në proces pune.

4.34 Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 21.3.2024, drejtuar FSHU-së, kërkoi informacion mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ndryshimet e tyre për objektin pa leje në Korçë, nga ku rezultoi se referuar sistemit të faturimit ka 2 kontrata furnizimi me energji elektrike, të cilat u përkasin abonentëve N (i cili ka ndryshuar emrin në A) dhe F.N. Kontratat janë hapur në shtator të vitit 2005, me adresë Rruga ***.

4.35 Sa i takon banesës në proces legalizimi, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në përdorim, ky i fundit ka shpjeguar se: *“Së pari, sqaroj se unë nuk kam qenë përdorues i kësaj banese. Në çdo deklaram timin kam deklaruar se kam qëndruar disa kohë në banesën e vëllezërve të mi, por jo se kam pasur në përdorim këtë banesë. Banesa është e tyre, e kanë përdorur dhe e përdorin vetë ata. Unë kam qëndruar në atë banesë, madje në të njëjtën dhomë me nënën time, si djali te nëna, por në asnjë formë përdorimi. Përderisa unë nuk kisha një shtëpi timen dhe në atë kohë isha transferuar në Korçë, pa dyshim që të banoja me nënën kishte përparësi. Në kohën e blerjes së truallit, vëllai A.N ka qenë në të njëjtën familje me nënën, B.N dhe dy vëllezërit, F.N dhe A.N. A.N është me aftësi të kufizuara. A.N ka blerë truallin, të formalizuar me kontratë, por trualli u përkiste të katërve.*

Vëllai A.N ka filluar të banojë në Korçë, në vitin 2000, ka transferuar gjendjen civile në Korçë, në vitin 2006.

*Vëllai F.N vazhdon të jetë i regjistruar në gjendjen civile në ish-komunën ***, ***, ndërsa jeton në Korçë. Sipas meje, ka ardhur në Korçë pas kthimit nga emigracioni, rreth viteve 2003 – 2004”.*

4.36 Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2024, i kërkoi informacion mbi gjendjen civile të shtetasve dhe çdo ndryshim kronologjik ndër vite, si dhe adresën aktuale të tyre , ku në përgjigje, Zyra e Gjendjes Civile Korçë konfirmon se shtetasi F.N nuk ka ndryshuar vendbanim dhe vazhdon të jetojë ende në fshatin ***, Bashkia ***, ndërsa shtetasi A.N nga data 1.1.2007 dhe në vazhdim ka qenë me vendbanim në qytetin e Korçës, në adresën Lagjja Nr. ***, “***”, përditësuar sipas adresarit në adresën Lagjja Nr. ***, rruga “***”, nr. ***, h. ***.

4.37 Në pyetëtorin nr. 3 lidhur me këtë banesë, burimin e krijimit të saj, shpenzimet e kryera dhe poseduesit e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

- Në kohën e blerjes së truallit, vëllai, A.N, ka qenë në të njëjtën familje me nënën, B.N, dhe dy vëllezërit, F.N dhe A.N. A.N ka blerë truallin, të formalizuar me kontratë, por trualli u përkiste të katërve.

- Burimi i blerjes kanë qenë të ardhurat nga familja bujqësore, në të cilën bënte pjesë edhe babai që ka ndërruar jetë në vitin 1999, të akumuluar nga kursimet e tyre në vite. Përveç kësaj, vëllezërit, A.N dhe F.N, kanë qenë në emigracion. A.N në vitet 1992 – 1999. F.N në vitet 1998 e më pas. Nuk mund të them me saktësi kur është kthyer, pasi nuk kam komunikime me të. Ata nuk disponojnë dokumente që të vërtetojnë të ardhurat e tyre.

- Ndërtimi i banesës ka filluar diku nga viti 2000 dhe ka vazhduar disa vite, por nuk ka dokument për ta provuar këtë nuk as për të dokumentuar shpenzimet për ndërtimin e banesës, ndaj nuk mund të përcaktohet sa kanë shpenzuar vëllezërit në çdo vit apo shpenzimet totale për ndërtimin e kësaj banese. Nuk kishin detyrimin dhe as mundësinë të dokumentonin shpenzimet e bëra.

4.38 Subjekti i rivlerësimit nuk ka përcjellë dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e të vëllait. Gjithashtu, në pyetësor deklaroi se vëllezërit nuk disponojnë dokumente që të vërtetojnë të ardhurat e tyre. Nga hetimi ka rezultuar se sipas verifikimit të kryer në bazën digjitale të të dhënave elektronike të ASHK-së, Drejtoria Vendore Korçë, vetëdeklarues është vetëm shtetasi A.N, sipas vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 14.11.2006, për objekt pa leje në Korçë.

4.39 Gjithashtu, edhe subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues, nga ku rezulton se për vetëdeklarimin nr. *** prot., datë 14.11.2006, dosja është ende në proces legalizimi, pa një vendim përfundimtar.

4.40 Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie, sipas dokumentacionit të administruar dhe deklarimit nga subjekti i rivlerësimit, duke marrë në konsideratë vlerën e miratuar sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 2000 për qytetin e Korçës (duke e konsideruar një kat ndërtimi 145 m^2 dhe në total ndërtesa 2 kate me sipërfaqe ndërtimi 290 m^2), kostoja e ndërtimit në Korçë për vitin 2000 është $21.266 \times 290 \text{ m}^2 = 6.167.140$ lekë.

4.41 Subjekti i rivlerësimit në këtë rast dështoi të bindte trupin gjykues lidhur me sa ka deklaruar, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, edhe në përgjigje të pyetjeve të bëra nga vëzhguesi ndërkombëtar gjatë seancës dëgjimore, së në banesën 2-katëshe në proces legalizimi kanë jetuar vetëm vëllezërit e tij, por asnjëherë ai.

4.42 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të vazhdueshme, nuk ka qenë koherent në deklarimet e tij lidhur me vendbanimet. Për më tepër, deklarimet kontradiktore të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, krahasuar me deklarimet periodike të tij dhe dokumentacionin e përfituar nga hetimi administrativ mbi vendbanimin e tij krijojnë paqartësi se ku ka jetuar subjekti i rivlerësimit ndër vite, duke e bërë të pamundur verifikimin e situatës reale.

4.43 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe kontradiktore, duke e vendosur organin e rivlerësimit në kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar pasuritë në përdorim nga subjekti i rivlerësimit dhe burimet e ligjshme të krijimit të tyre dhe e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 61, si dhe cenojnë shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

5. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë e tij.

5.1 Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, rrethanat e konstatuara në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, bazuar në konkluzionet e arritura më lart, çojnë në përfundimin se **subjekti i rivlerësimit, z. Dashnor Nure, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

6. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, pas verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 10/2023, datë 2.2.2023, si dhe në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka kryer të gjitha procedurat për

kontrollin figurës, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 2.11.2017, rishikuar me nr. *** prot., datë 2.7.2024, për subjektin Dashnor Nure, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 3.7.2024.

6.1 Në këtë raport të rishikuar është konstatuar se, bazuar në informacionin e ardhur nga institucionet verifikuese, rezulton se disponohen të dhëna mbi përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e ndërveprimit korruptiv.

6.2 Komisioni, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar informacion dhe duke analizuar dosjet penale të lidhura me këto të dhëna.

6.3 Në vlerësimin e këtyre dy çështjeve, nga ana e trupit gjykues mbahet sa ka rezultuar nga aksesimi nga ana e trupit gjykues të Komisionit, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar të ONM-së, në informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga Shërbimi Informativ Shtetëror për kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, me qëllim verifikimin e burimeve të informacionit të paraqitur nga Grupi i Punës në raportin e Autoritetit Kombëtar të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

6.4 Aksesimi i informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke u vënë në dispozicion të trupit gjykues të Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së dosja që i përket praktikës së verifikimit të kryer për kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit.

6.5 Në kuadër të standardit të vendosur nga jurisprudenca e GJEDNJ-së në çështjen Regner kundër Republikës Çeke, njohja me provat e administruara gjatë hetimit të Komisionit, për shkak të natyrës së informacionit që mbart dhe kushtet specifike të ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të tij, u krye pranë ambienteve të autoritetit kompetent shtetëror. Trupi gjykues verifikoi në vend të njëjtin informacion të aksesuar nga Grupi i Punës së AKSIK-së, si dhe burimet e informacionit.

a. Lidhur me dosjen penale nr. *, që i përket të pandehurit I.C**

Nga verifikimi i akteve në dosje, Komisionit i rezultoi si vijon:

Dosja i përket procedimit penal nr. ***, i regjistruar ndaj shtetasit të lartpërmendur nën akuzën “Prerja e paligjshme e pyjeve”, neni 205 i Kodit Penal.

Subjekti i rivlerësimit me vendimin datë 22.9.2014 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”.

Vendimi është bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pasi shkeljet sipas këtij neni trajtohen si kundërvajtje administrative. Bazuar në nenin 38/1, shkronja “a”: “Prerja pa leje e pyjeve, e pyjeve të reja, e filizërisë dhe e fidanishteve, si dhe dëmtimi i tyre e i tokës pyjore, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me sanksion administrativ gjorbë”.

Për sa bazuar në nenin 38/2, parashikohet se: “Kur shkeljet e këtij ligji kanë sjellë pasojat të rënda, Policia Pyjore bën kallëzim penal”. Pavarësisht kallëzimit, subjekti i rivlerësimit e ka konsideruar

veprimin kundërvajtje administrative dhe jo penale, duke vlerësuar se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi që subjekti të japë argumente dhe shpjegime në lidhje me vendimmarrjen e tij në këtë dosje penale.

Subjekti në prapësimet e tij ka shpjeguar se *vepra penale “Prerja e paligjshme e pyjeve”* parashikohet në nenin 205 të Kodit Penal si kundërvajtje penale.

Bazuar në formulimin e kësaj dispozite, parashikimet e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, edhe në të gjitha ligjet e tjera, të mëparshme apo të mëvonshme, si dhe në aktet e tjera nënligjore, të dala në funksion të zbatimit të këtij ligji, tregojnë se kjo dispozitë është blanket. Subjekti shpjegon se ai i është referuar jo vetëm dispozitës penale, por edhe akteve të tjera ligjore apo nënligjore, në të cilat referohet zbatimi i kësaj vepre penale.

Prandaj në vendimmarrjen e tij të arsyetuar në vendimin e mosfillimit janë marrë parasysh, në mënyrë kumulative, edhe përkufizimet e nenit 205 të Kodit Penal, si dhe parashikimet e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe parashikimet e VKM-së nr. 108, datë 21.9.2009.

Qëndrimi i Komisionit

Duke mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e arsytimit të vendimeve, si një garanci për procesin e rregullt ligjor, vlerëson se arsyetimi i dhënë në procedimin penal nga subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së një argumentimi ligjor, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, pasi:

- Nisur nga fakti që në kallëzim është kërkuar ndjekja penale, subjekti i rivlerësimit ka kanalizuar të dhënat e kallëzimit drejt procesit administrativ, dhe nuk ka konsideruar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale.

b. Lidhur me dosjen penale me të pandehur G. Gj., dënuar me burgim të përjetshëm

Komisioni ka administruar dosjen penale me të pandehur G. Gj., dënuar me burgim të përjetshëm nga Gjykata për Krime të Rënda në Milano, i cili ka marrë formë të prerë nga Gjykata e Apelit Milano, për veprën penale të vrasjes me paramendim, në dy raste, mbajtjes pa leje të armëve luftarake, prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga Kodi Penal italian dhe dënuar me burgim të përjetshëm.

Dënimet janë bashkuar në një dënim të vetëm nga Prokuroria e Milanos dhe vendimi është njohur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e më pas lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Nga aktet e administruara në dosje rezulton se me autorizimin e drejtuesit të prokurorisë, datë 14.9.2018, subjekti i rivlerësimit është autorizuar të marrë pjesë në gjykimin e çështjes penale, me kërkues G. Gj., me objekt lirim me kusht.

Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit mbi procedurën e ndjekur për shpërndarjen e çështjes me short, si dhe paraqitjen e dokumentacionit provues.

Me pyetësin nr. 3, datë 15.4.2024, subjekti ka deklaruar: “...Shpërndarja e çështjeve me short bëhet nga drejtuesi i Prokurorisë. Unë nuk kam pasur, as nuk kam asnjë akses në shpërndarjen e çështjeve, të çfarëdolloj natyre qofshin. Me sa di, si rregull, çështjet ndahen me short në mënyrë elektronike, nëpërmjet një sistemi që përdoret nga punonjësi i IT-së. Hedhjen e të dhënave në sistemin e ndarjes së çështjeve me short e bën punonjësi i IT-së. Unë e marr në dorë çështjen e caktuar me short nga sekretaria, pas regjistrimit të kallëzimit apo çështjes në regjistrin përkatës, me shënimet e bëra nga drejtuesi apo personi i autorizuar prej tij, zakonisht zëvendësdrejtuesi apo drejtuesi i seksionit. Ky rregull ndiqet për kallëzimet e reja, procedimet e reja apo edhe rastet e zëvendësimit të prokurorit.

Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e hetimit, duket se subjekti ka përfaqësuar organin e akuzës, në mosrespektim të udhëzimit nr. 03, datë 29.12.2018 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, i cili parashikon se shpërndarja e çështjeve në prokurori si rregull bëhet me short elektronik.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur pranimin e kërkesës së të dënuarit G. Gj., me objekt “Lirim me kusht”, për pjesën tjetër të mbetur pa vuajtur të dënimit me burgim të përjetshëm. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së të dënuarit G. Gj., pa argumentuar arsytet e këtij kërkimi.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, të shpjegojë sa duket se:

- Kjo dosje ishte marrë prej tij pa iu nënshtruar shortit elektronik, në kundërshtim me parashikimet ligjore sipas udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016.
- Në të njëjtën ditë me marrjen e autorizimit ai ka marrë pjesë në seancën gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Subjekti në prapësimet e tij ka shpjeguar: *Shpërndarja e çështjeve me short bëhet nga drejtuesi i prokurorisë, i cili zgjedh formën e shortimit, manual ose elektronik. Udhëzimi parashikon si rregull shortin elektronik, por nuk përjashton forma të tjera të shortimit, sidomos kur shorti elektronik nuk është i mundur. Përgjegjësia për formën e zgjedhur për caktimin e shortit, manual apo elektronik, është e drejtuesit të prokurorisë dhe jo e subjektit të rivlerësimit.*

Subjekti ka kërkuar rrëzimin e kërkesës në seancë, pasi nuk plotësoheshin kushtet për pranimin e kërkesës. Gjithashtu, ai shpjegon se e ka apeluar vendimin e gjykatës në datën 27.2.2019 dhe se ka parashtruar në mënyrë të detajuar arsytet pse kërkuesi nuk duhej të lirohej me kusht. Në këtë rast, arsyetimi i ankimit bëhet i detyrueshëm, pasi dispozitat mbi ankimin parashikojnë se Gjykata e Apelit mund të vendosë vetëm mbi shkaqet e paraqitura në ankim.

Më tej, subjekti shpjegon se ndaj ankimit Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së të dënuarit G. Gj., për lirim me kusht.

Qëndrimi i Komisionit

Shpjegimet e subjektit se udhëzimi nr. 3, datë 29.12.2016, i Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” dhe përgjegjësia e zbatimit të tij i takon vetëm drejtuesit të prokurorisë, nuk janë të bazuara në ligj.

Përdorimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve duhet të kryhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

Zbatimi i parashikimeve ligjore sa më sipër është detyrë jo vetëm e drejtuesit, por edhe e prokurorit të çështjes, për të siguruar pavarësinë e tij referuar parashikimeve të bëra në nenin 6 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Konkluzion për kontrollin e figurës

7. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të figurës, rezultateve të hetimit lidhur me çështjet e referuara më lart, si dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë edhe subjekti, krijoi bindjen se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Dashnor Nure, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ishin të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete.

7.1 Në këndvështrimin e përgjithshëm, edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjyqës vlerëson se mospërmbyllja e rregullt e detyrës cenon pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit, z. Dashnor Nure, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

8. Vlerësimi profesional është kryer për subjektin e rivlerësimit nga organi kompetent, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreut VI, nenet 40 e vijues të tij, si dhe mbi bazën e kriterëve përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

8.1 Raporti për analizën e aftësive profesionale është hartuar bazuar në formularin e vetëdeklarimit, përshkrimin dhe analizimin e tri dokumenteve të përzgjedhura nga vetë subjekti, pesë dosjeve të përzgjedhura bazuar në sistemin rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti nr. 1 – Vendim për pushimin e çështjes penale nr. ***

Materiali kallëzues referuar nga Komisariati i Policisë Korçë për konsumimin e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë plagosjen e rëndë të një personi dënohet...”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal ndaj shtetasit G.H, me të dëmtuar shtetasin N.A.

Subjekti në mbështetje të nenit 328/1, shkronja “b” dhe nenit 190/1, shkronjat “c” dhe “ç” të Kodit të Procedurës Penale, ka përpiluar vendimin “*Pushimin e çështjes penale nr. ***, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë plagosjen e rëndë të një personi dënohet...”*”.

Sa i takon statusit të kësaj çështjeje, nga hetimi i Komisionit rezultoi se ka përfunduar gjykimi i çështjes penale me objekt “Ankim kundër vendimit të pushimit”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të pushimit.

Dokumenti nr. 2 – Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***

Vepra penale është referuar nga Komisariati i Policisë Korçë, në ngarkim të të pandehurve Th.D, hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja”, e kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

R.D, me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, hetuar me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, bazuar në nenin 331/1 të Kodit të Procedurës Penale i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë: *Gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurve Th.D, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhje e pasurisë më shumë se një herë (një herë në bashkëpunim) parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, dënimin e tij me 5 vjet burgim dhe R.D, akuzuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes së pasurisë, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, dënimin e tij me 6 muaj burgim.*

Sa i takon statusit të kësaj çështjeje, rezultoi se me vendimin nr. ***, datë 18.5.2016, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi deklarinimin fajtor të të pandehurve sipas kërkesës së prokurorit. Ndaj këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 10.11.2016 (vendimi ka marrë formë të prerë), ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Dokumenti nr. 3 – Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***

Vepra penale është referuar nga oficeri i policisë gjyqësore i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin. Procedimi penal është në ngarkim të shtetasit të huaj J.D, i hetuar me masë sigurimi

“Arrest në burg”, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i mjeteve motorike kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 141/a/2 i Kodit Penal.

Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, bazuar në nenin 331/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar: *Gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2016, me të pandehur J.D, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i mjeteve motorike kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 141/a/2 i Kodit Penal.*

Sa i takon statusit të kësaj çështjeje, rezulton se me vendimin nr. ***, datë 18.11.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi deklarinimin fajtor të të pandehurve sipas kërkesës së prokurorit. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 19.11.2016.

Sa i takon 3 dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti, Komisioni konstaton se nuk ka problematika.

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE PËR PROKURORIN DASHNOR NURE, TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja nr. 1 – Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. *, datë 11.1.2013**

Kallëzimi penal nr. ***, datë 10.1.2013, është regjistruar mbi bazën e referimit të veprës penale nga Drejtoria e Policisë të Qarkut Korçë.

Zyra e Interpol Tiranës me shkresë në Policinë e Qarkut Korçë ka kërkuar verifikimin e dokumenteve certifikatë personale dhe certifikatë familjare, datë 2.12.2004. Materiali kallëzues është referuar për hetimin e veprës penale “Falsifikimi i akteve të gjendjes civile”, parashikuar nga neni 191 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se në certifikatat e gjendjes civile të përdorura nga shtetasja M.J janë paraqitur të dhëna të rreme në lidhje me kombësinë e saj. Në rubrikën e kombësisë është shënuar fjala “greke”, ndërsa sipas certifikatave elektronike, të cilat u janë bashkëlidhur certifikatave objekt hetimi, rezulton se kombësia e shtetasës M.J është “shqiptare”. Nuk dihet me saktësi se kush e ka kryer falsifikimin e akteve. Referuar paragrafit të parë të nenit 191 të Kodit Penal, i cili ka këtë parashikim: *“Falsifikimi ose përdorimi i akteve të gjendjes civile të falsifikuara dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet ose me gjobë nga treqind mijë lekë deri në gjashtëqind mijë lekë”*. Në rastin kur falsifikimi kryhet nga punonjësi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, rasti do të kualifikohej sipas paragrafit të tretë të nenit 191, i cili ka këtë parashikim: *“Kur falsifikimi kryhet nga punonjësi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet ose me gjobë nga një milion deri në tre milionë”*. Data e lëshimit të certifikatave rezulton të jetë 2.12.2004, pra falsifikimi është kryer para kësaj date, e nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar më shumë se 5 vjet. Bazuar në nenin 66 të Kodit Penal, nuk mund të ushtrohet ndjekje penale, sepse nga momenti i kryerjes së veprës penale deri në datën që është paraqitur kallëzimi penal janë plotësuar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale prej 5 vitesh.

Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të neneve 290/1/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: *“Mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 191 i Kodit Penal”*.

Nga aktet e dosjes rezulton se vendimi përfundimtar për mosfillimin e çështjes është marrë në respektim të afatit 30-ditor maksimal, nga momenti i regjistrimit të kallëzimit penal, afat i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012 “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” (i ndryshuar)”, i Prokurorit të Përgjithshëm.

Sa i takon statusit të kësaj çështjeje, nga hetimi i Komisionit rezulton se me shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton se vendimi i mosfillimit të procedimit penal nr. *** nuk është ankimuar në gjykatë.

Dosja nr. 2 – Vendim për pushimin e çështjes, procedimi penal nr. *, datë 3.4.2015**

Procedimi penal nr. ***, datë 3.10.2014, është regjistruar mbi bazën e referimit të veprës penale nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, ndaj shtetasit L.D për veprën penale “Falsifikimi i vulave, i stampave dhe i formularëve”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

Nga hetimi paraprak i zhvilluar dhe materiali kallëzues ka rezultuar e provuar se policia gjyqësore ka pasur informacion konfidencial se shtetasi L.D tregtonte kafe që e bluate në çast, për të cilën nuk kishte dokumentacion për ushtrimin e veprimtarisë. Policia gjyqësore ka sekuestruar ambalazhe letre me mbishkrim në gjuhën greke, të cilat shërbenin për paketimin e kafes së bluar, si dhe pako të mbushura me kafe të bluar.

Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë rezulton se objekti i aktivitetit të shtetasit L.D është “Tregti me pakicë e artikujve të ndryshëm”. Dega Doganore Korçë konfirmon se subjekti nuk ka importuar apo eksportuar në Doganën Korçë. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Drejtoria Rajonale Korçë konfirmon se shtetasi L.D nuk është i regjistruar dhe i kontrolluar si subjekt pranë kësaj Drejtorie. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 23.12.2014 (kopje e shkresës, administruar në funksion të një procedimi tjetër penal me nr. ***, viti 2014), rezulton se subjektet që konsiderohen si biznes i vogël nuk trajtohen nga Qendra Kombëtare e Licencimit për të ushtruar aktivitetin e prodhimit, paketimit dhe shitjes së kafes.

Bazuar në nenin 2, pika 1 e ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, ky ligj zbatohet në prodhimin primar dhe në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë. Sipas nenit 3, pika 1 e ligjit të sipërcituar: *“Ushqim ose produkt ushqimor është çdo substancë ose produkt i përpunuar, pjesërisht i përpunuar ose i papërpunuar, i përcaktuar të jetë ose jo për ndonjë arsye i konsumueshëm për njerëzit”*.

Në kuptim të këtyre dispozitave, pjekja, bluarja dhe tregtimi i kafes janë pjesë e procesit të prodhimit të ushqimit. Sipas nenit 28 të ligjit të sipërcituar për nxjerrjen në treg të ushqimeve të reja, aplikuesi duhet të marrë leje nga ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pas dhënies së mendimit paraprak shkencor të AKU-së. Kategoritë e ushqimeve të reja parashikohen në nenin 27 të këtij ligji, ku del e qartë se kafja, si prodhim primar ushqimor, pjekja, bluarja dhe tregtimi i saj, nuk bëjnë pjesë në kategorinë e ushqimeve të reja dhe nuk kërkohet leje e veçantë.

Edhe në përgjigje të AKU-së, Drejtoria Rajonale Korçë, për bizneset e vogla nuk është e nevojshme pajisja me leje nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Biznesi i vogël nuk është subjekt

që trajtohet nga AKU-ja. Pra, shtetasi L.D për ushtrimin e aktivitetit të tij nuk ka pasur detyrimin të pajisej me leje specifike nga AKU-ja, as nga ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e, si rezultat, veprimet e tij nuk përmbajnë elementet e figurës së veprës penale “Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë”, parashikuar nga neni 288/a i Kodit Penal.

Nga ana e policisë gjyqësore janë referuar aktet edhe për veprën penale “Falsifikimi i vulave, i stampave dhe i formularëve”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, pasi janë sekuestruar disa ambalazhe prej letre me mbishkrime në gjuhë të huaj. Letrat e ambalazhit janë përdorur për ambalazhimin e artikujve ushqimorë, nuk kanë elemente të stampave, pra nuk është kryer vepra penale e parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, e si rezultat çështja penale duhet të pushohet, bazuar në nenin 328/1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale.

Në kushtet kur nuk është kryer vepra penale, parashikuar nga neni 288/a i Kodit Penal, në mbështetje të nenit 328/1, shkronja “b” dhe nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale: *“Subjekti ka vendosur pushimin e çështjes dhe sendet e sekuestruara t’i kthehen personit që i përkasin”*.

Sa i takon statusit të kësaj çështjeje, nga hetimi i Komisionit rezulton se vendimi i pushimit për procedimin penal nr. *** nuk është ankimuar në gjykatë.

Dosja nr. 3 – Vendim për pushimin e çështjes, procedimi penal nr. ***

Procedimi penal nr. ***, datë 4.9.2013, është regjistruar mbi bazën e referimit të veprës penale nga Komisariati i Policisë Korçë, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal.

Në datën 1.8.2013, shtetasen A.E e kanë çuar për ndihmë mjekësore në Spitalin Civil Korçë, ku ka ndërruar jetë. Shtetasi M.E, djali i së ndjerës, ka deklaruar se nëna e tij ishte në gjendje jo të mirë nga tensioni. Nga këqyrja e kufomës nga pamja e jashtme rezultoi se nuk kishte pasur shenja dhune të jashtme.

Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. ***, ka rezultuar se: *“Në trupin e shtetases A.E nuk u konstatuan shenja dhune. Shkaku i vdekjes së shtetases A.E është infarkti i miokardit”*.

Bazuar në deklarimet, në procesverbalin për këqyrjen e kufomës, si dhe në aktin e ekspertimit mjekoligjor, del qartë se vdekja e shtetases A.E ka ardhur për shkaqe natyrale dhe nuk është shkaktuar si rezultat i veprimeve të anës objektive të ndonjë vepre penale. Ky fakt nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në mbështetje të nenit 328/1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur: *“Pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2013, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, që lidhet me vdekjen e shtetases A.E, banuese në ***”*.

Sa i takon statusit të kësaj çështjeje, nga hetimi i Komisionit rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë konfirmon se ndaj vendimit të pushimit për kallëzimin penal nr. *** nuk është ankimuar në gjykatë.

Dosja nr. 4 – Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***

Procedimin penal nr. ***, datë 3.6.2016, është referuar nga Komisariati i Policisë Korçë në ngarkim të shtetasve M.R, M (V) D e D.K, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

Në datën 1.6.2016 është konstatuar vjedhja e disa banesave të shtetasve, të cilët jetonin në emigracion, dhe është njoftuar Policia e Korçës. Të pandehurit, të pyetur në cilësinë e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetimet, kanë pohuar se kanë hyrë në banesa për të vjedhur sendet në bashkëpunim.

Bazuar në sa më sipër, të dyshuarit, shtetasit M.R, M.D dhe D.K, hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg”, janë marrë të pandehur për veprën penale “Vjedhja e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

Në mbështetje të nenit 331/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka kërkuar gjykimin e çështjes penale me të pandehur M.R, M.D dhe D.K, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

Sa i takon statusit të kësaj çështjeje, nga hetimi i Komisionit rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 21.9.2016, ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurve për kryerjen e veprës penale “Vjedhja në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. I pandehuri M.R ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

Dosja nr. 5 – Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***

Procedimi penal nr. ***, datë 17.2.2016, është referuar nga Komisariati i Policisë Korçë, në ngarkim të shtetasit N.P, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Kallëzimi penal është bërë nga shtetasi I.P.

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se shtetasi I.P në datën 29.12.2015 ka pasur bagëtitë në kullotë dhe ka konstatuar se i mungonte një shqerrë. Në datën 31.12.2015 ka mësuar se shqerra mbahej nga i pandehuri N.P. Ky i fundit ka pretenduar se në datën 29.12.2015 ka gjetur në arat e tij të mbjella me jonxhë një tufë bagëtish dhe shqerra, të cilat i kanë dëmtuar rreth 4.5 dynym jonxhë dhe ka marrë një shqerrë, me qëllim për ta detyruar pronarin e dheneve që të paguante dëmin e shkaktuar.

Prokurori ka konkluduar se i pandehuri ka konsumuar elementet e veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

Bazuar në nenin 331/1 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti në datën 17.5.2016 ka kërkuar: *Gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2016, me të pandehur N.P, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.*

Sa i takon statusit të kësaj çështjeje, nga hetimi i Komisionit rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 27.9.2016, bazuar në nenin 388, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur të deklarojë të pafajshëm të pandehurin. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar ankimin ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke kërkuar “Ndryshimin e

vendimit nr. ***, datë 27.9.2016”. Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 6.6.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pushimin e çështjes penale për shkak të ligjit nr. 141/2016 për dhënie amnistie. Vendimi ka marrë formë të prerë, referuar shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Nga shqyrtimi i akteve të subjektit të rivlerësimit për 5 dosjet e përzgjedhura me short, Komisioni konstaton se nuk ka problematika.

ANALIZA E GJETJEVE

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi të mira në drejtim të zbatimit të ligjit, në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ai përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj, në rastin konkret hetimi.

Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale, shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të akteve që normojnë fushën e ndërtimit, institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, detyrave përkatëse të çdo punonjësi të këtyre institucioneve.

Subjekti shfaq njohuri të plota në drejtim të kuptimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Subjekti e ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë për procedimet, të cilat janë ndjekur prej tij. Pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti përcakton me shkrim detyrat e oficerit të policisë gjyqësore, duke përcaktuar çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afat. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme, bën interpretim sistematik dhe logjik të normës ligjore në raport me faktin e referuar dhe konkludon në një zgjidhje ligjore të rastit.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të arsyetimit ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e tij të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsyetimeve. Subjekti tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Në tetë aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, analizë e zgjeruar e provave të mbledhura, provave të paraqitura nga mbrojtja, si dhe kërkesave dhe pretendimeve të mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave, rezulton se për periudhën e punës subjekti i rivlerësimit ka trajtuar 701 çështje. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 24.1.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit qershor 2014 – tetor 2016, rezulton se nga ana e subjektit tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure kryen veprime procedurale hetimore, të cilat rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet se veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve, konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

Gjithashtu, qëndrimi i subjektit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti i rivlerësimit Dashnor Nure ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga tetë aktet rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e tyre është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nuk rezulton të ketë pasur ankesa apo të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk konstatohet përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga dokumentet e vëzhguara vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Dashnor Nure për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “mirë” dhe “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

Konkluzion për vlerësimin e aftësisë profesionale

9. Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësisë profesionale.

DENONCIME

10. Komisioni, ka analizuar denoncimet për subjektin e rivlerësimit, Dashnor Nure duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime edhe lidhur me denoncimin e shtetas Xh.Q.

10.1 Shtetasja Q denoncon se *subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar çështjen siç duhet, shumë procese janë anashkaluar, si dhe të dhënat në dosjen hetimore janë kontradiktore, se nga njëra anë thonë se i ndjeri ka konsumuar alkool dhe, nga ana tjetër, akti toksikologjik thotë që në trupin e të ndjerit nuk është gjetur asnjë lëndë psikotrope apo alkoolike.* Bashkëlidhur denoncimit, është përcjellë kopja e fashikullit penal, që i përket procedimit penal nr. ***, kallëzimi nr. ***, adresuar ndaj shtetasit Gj.N, akuzuar për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.

Rrethanat e çështjes penale

10.2 Në datën 25.3.2014, shtetasi M.Q, së bashku me disa shtetas, ka konsumuar alkool dhe, pasi nuk është ndier mirë, është dërguar në spital në repartin e urgjencës, ku është ekzaminuar nga i pandehuri, mjeku Gj.N.

10.3 Pas vizitës që i është bërë pacientit, i është dhënë mjekim dhe gjendja e tij është normalizuar. Shtetasi M.Q dhe personi që e shoqëronte janë larguar nga spitali dhe kanë konsumuar një hamburger. Rrugës për në shtëpi, viktima nuk është ndier mirë dhe është dërguar përsëri në urgjencën e spitalit, ku mjekët kanë konstatuar se ai kishte vdekur.

10.4 Fillimisht janë regjistruar dy procedime për të njëjtën veprë penale, për të cilat me vendimin datë 26.7.2014 është bërë bashkimi i tyre, bazuar në nenin 79/1, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Penale, në një procedim të vetëm, me nr. ***, datë 26.7.2014, pasi dyshohet se veprat penale janë kryer nga i njëjti person.

Përmbledhje e procedimit penal

10.5 Fillimisht referimi i veprës penale është bërë nga Komisariati i Policisë Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 27.3.2014. Më pas, referimi i veprës penale pasqyron kallëzimin e bërë nga shtetasja Xh.Q, në datën 24.7.2014, për shtetasin Gj.N, me detyrë mjek, për shkak se vëllai i saj, viktima M.Q, ka shkuar tek urgjenca e spitalit dhe mjeku nuk i ka kushtuar vëmendje shqetësimeve të tij. Sipas pretendimeve të saj, mjeku ka shpërdoruar detyrën dhe nuk ka kryer siç duhet funksionin e tij.

10.6 Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë i ka përcjellë me shkresë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë materialet procedurale për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Për hetimin e kësaj çështjeje prokurori/subjekti i rivlerësimit në datën 7.8.2014 ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore të kryejë veprimet hetimore brenda datës 20.9.2014, të cilat janë përmbushur prej tij.

10.7 Më konkretisht ai ka urdhëruar:

- Në datën 21.10.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë i ka dërguar Institutit të Mjekësisë Ligjore: (i) vendimin për caktimin e ekspertit mjekoligjor; (ii) aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 15.7.2014 (shkaku i vdekjes së viktimës ka ardhur si rezultat i pankreatitit akut dhe nekrozës akute të pankreasit, shoqëruar me dëmtime multiorganore); (iii) aktin e ekspertimit toksikologjik-ligjor nr. *** “Mbi ekspertimin toksikologjik të gjakut të viktimës”, datë 30.4.2014 (me konstatimin që në gjakun e viktimës nuk u zbuluan lëndë helmuese, alkool etilik, lëndë narkotike); (iv) procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve. Aktet e mësipërme janë firmosur nga një ekspert.

10.8 Në vendimin datë 21.10.2014, OPGJ-ja i Prokurorisë sqaron se në dosje janë administruar aktet e ekspertimit të mësipërm, por për nevoja hetimi është e nevojshme kryerja e hetimit mjekoligjor, pasi nevojiten njohuri të posaçme nga një grup ekspertësh, specialistë të fushës.

10.9 Instituti i Mjekësisë Ligjore ka përcjellë me shkresë aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. ***, me konstatimin: *Për pasojë të diagnostikimit të gabuar, edhe mjekimi ka qenë jo i duhuri. Mangësitë e konstatuara përbëjnë shkelje mjekësore, të cilat kanë ndikuar në ardhjen e pasojës, vdekjes së viktimës.*

10.10 Subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe të emrit të personit, të cilit i atribuohet vepra penale, shtetasit Gj.N, në datën 18.11.2014.

10.11 OPGJ-ja i ka dorëzuar subjektit në datën 25.11.2014 relacionin mbi përfundimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2014, me konstatimin se: *Nga ana e mjekut të urgjencës ka shkelje në ekzaminimin e tij, nuk është hapur kartelë, nuk është bërë asnjë konsultë diagnostikuese. Për pasojë të diagnostikimit të gabuar, edhe mjekimi ka qenë i gabuar. Veprimet hetimore janë të plota, mjeku ka kryer veprën penale “Mjekimi i pakujdesshëm”, neni 96 i Kodit Penal.*

10.12 Në procesverbalin e datës 15.12.2014, shtetasi ndaj të cilit zhvillohen hetimet nuk ka qenë dakord me aktekspertimin mjekoligjor nr. ***, datë 7.11.2014 dhe i ka kërkuar subjektit rishikimin e tij.

10.13 Në datën 23.12.2014, prokurori ka marrë vendimin për kryerjen e ekspertimit të ri mjekoligjor nga të paktën 2 ekspertë të tjerë dhe sipas konstatimit se nga ana e ekspertëve të ngarkuar me kryerjen e ekspertimit nuk janë përpiluar deklarata sipas kërkesave të nenit 183¹ të Kodit të Procedurës Penale.

10.14 Në vijim të hetimeve, pas relacionit përfundimtar të OPGJ-së, prokurori/subjekti në datën 18.2.2015 ka marrë vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve nga data 18.2.2015 deri më 18.5.2015, me argumentin se deri në këtë fazë të hetimeve, në varësi të konkluzioneve të ekspertimit, mund të lindë e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera edhe për faktin se ende nuk është vënë në dispozicion akti i ekspertimit mjekoligjor.

10.15 Në aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 15.7.2014, *shkaku i vdekjes së viktimës ka ardhur si rezultat i pankreatitit akut dhe nekrozës akute të pankreasit, shoqëruar me dëmtime multiorganore* (një ekspert).

10.16 Në aktin e ekspertimit mjekoligjor, nr. ***, datë 7.11.2014, me konstatimin: *Për pasojë të diagnostikimit të gabuar, edhe mjekimi ka qenë jo i duhuri. Mangësitë e konstatuara përbëjnë shkelje mjekësore, të cilat kanë ndikuar në ardhjen e pasojës, vdekjes së viktimës* (2 ekspertë, specialistë të fushës).

10.17 Prokurori në datën 18.5.2015 ka marrë vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve nga data 18.5.2015 deri më 18.8.2015, me të njëjtat argumente, si për zgjatjen e afatit nga data 18.2.2015 deri më 18.5.2015.

10.18 Nga aktet në fashikull rezulton se Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar aktin e riekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 18.5.2015, nga ku rezulton se mjekimi i aplikuar ndaj shtetasit M.Q ka qenë në përputhje me sëmundjen që ka menduar mjeku i urgjencës dhe jo me sëmundjen nga e cila vuante, në këtë rast pankreatiti akut fulminant. Ekzaminimi ka qenë i përciptë, nuk ka qenë i thelluar. Ecuria e sëmundjes ka qenë shumë e shpejtë, por nëse mjeku mund të ishte thelluar, vdekja mund të ishte shmangur. Për mangësitë gjatë trajtimit mban përgjegjësi mjeku që është marrë me trajtimin e tij.

10.19 OPGJ-ja në datën 25.5.2015 i ka paraqitur prokurorit të çështjes relacionin mbi përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2014, duke sugjeruar dërgimin e çështjes në gjykatë për gjykim në ngarkim të shtetasit Gj.N për veprën penale “Mjekimi i pakujdesshëm”, më pas, subjekti ka ndjekur veprimet e mëtejshme procedurale.

10.20 Subjekti i rivlerësimit me vendimin datë 1.6.2015 ka vendosur të dërgojë çështjen penale në gjyq për veprën penale “Mjekimi i pakujdesshëm”, duke kërkuar: Deklarimin fajtor sipas nenit 96

¹ Neni 183/1: “*Organi procedues, pasi sigurohet për identitetin e ekspertit, e pyet nëse ka shkaqe përjashtimi nga detyra e ekspertit, e paralajmëron për detyrimet e përgjegjësitë e parashikuara nga ligji penal, i formulon kërkesat e ekspertimit dhe e fton të bëjë këtë deklaratë: “I vetëdijshëm për përgjegjësinë morale dhe juridike për detyrën që marr përsipër, do ta kryej atë me ndershmëri e drejtësi dhe do të ruaj sekretin për të gjitha veprimet që lidhen me ekspertimin”. 2. Shpërblimi i ekspertit ...”.*

dhe dënimin e tij me 3 vite burgim/Aplikimin e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe gjykim të shkurtuar e, për rrjedhojë, dënimin me 2 vjet burgim;/Heqjen e së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë 2 vjet.

10.21 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. ***, datë 28.7.2015, ka vendosur sipas kërkesës së organit të akuzës. Kundër vendimit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë nga i pandehuri Gj.N. Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 22.12.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe *pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit për zbatim të gabuar të ligjit, të provave të administruara në dosje gjatë shqyrtimit gjyqësor.*

10.22 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumente në lidhje me sa duket se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet: *“Prokurori ushtron ndjekjen penale..., drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm...”*.
- Subjekti nuk ka kryer veprime hetimore nga data 18.2.2015 deri më 18.5.2015. Vetëm në datën 12.5.2015 me shkresë të drejtuesit të prokurorisë është kërkuar kryerja e ekspertimit mjekoligjor; nuk ka administruar deklaratat e ekspertëve, të cilat nuk rezultojnë në dosje.

10.23 Subjekti në prapësimet e tij, ka shpjeguar: *“Për periudhën 18.2.2015 – 18.5.2015 nuk janë kryer veprime hetimore, pasi ka vlerësuar se ato ishin të plota, me përjashtim të administrimit të aktit të ekspertimit mjekoligjor, akt i cili ka ardhur dhe është administruar pas datës 18.5.2015, në datën 25.5.2014.*

Lidhur me mungesën e deklaratave të ekspertit, sqaroj se për aktet e ekspertimit që kryheshin nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Instituti i Policisë Shkencore, ato nuk shoqëroheshin me deklaratën e ekspertit, pasi në vendimin e ekspertimit nuk mund të caktohej emri i ekspertit, pasi nuk njihej dhe ai caktohej nga institucioni. Rrjedhimisht, deri vonë këto akte janë pranuar nga të gjithë prokurorët edhe nga gjykatat të pashoqëruara me deklaratën e ekspertit. Kohën e fundit është kthyer në praktikë të konsoliduar që aktet e ekspertimit të kryer nga ekspertë të këtyre fushave shoqërohen edhe me deklaratën e ekspertit”.

Qëndrimi i Komisionit lidhur me denoncimin

10.24 Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas të cilave ai nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe mbi mungesën e kryerjes së veprime hetimore prej tij nga data 18.2.2015 deri më 18.5.2015.

10.25 Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti ka treguar mangësi në përmbushjen e rregullt e detyrës, duke cenuar shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatores së çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura, në vlerësimin e çështjes në tërësi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Dashnor Nure, nuk ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë dhe në vlerësimin tërësor ka cenuar besimin e publikut te drejtësia në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, nenit 58, shkronja “c” e pikës 1, dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dashnor Nure, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 4.9.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Mevi Dibra